



Fier më 14.04.2021

### KALLËZIM PENAL

**KALLËZUES:** Partia Demokratike Dega Fier, përfaqësuar nga Z. Enkelejd Alibeaj Drejtues Politik i Partisë Demokratike në Qarkun Fier.

**OBJEKTI:** Kallëzim i veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**KUNDËR:**

[REDACTED]

**BAZA LIGJORE:** Nenet 75/a, 280, 283 e vijues të K.Pr.Penale, neni 248 i Kodit Penal, neni 79 i Kodit Zgjedhor dhe neni 3 i Udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

**DREJTUAR:** Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

*I/E nderuar Z/Znj. Prokuror/e,*

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, po ju parashtrojmë këtë Kallëzim Penal për veprën penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, dispozitat ligjore penale të cënuara, si dhe analizën juridike dhe provat me anë të të cilave vërtetohet konsumimi i veprës penale.